



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

## **Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale**

### **Plani i punës së Komisionit për Tetor – Dhjetor 2017**

Prishtinë;  
18 Tetor 2017

Kryetare e Komisionit  
**Besa Baftiu**

## **I. Hyrje**

Në bazë të Rregullores së Kuvendit të Kosovës dhe praktikës së punës së Komisioneve Parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka hartuar planin e aktiviteteve për muajt tetor – dhjetor 2017. Plani i punës së Komisionit mund të ndryshoj sipas nevojës dhe aktiviteteve të Komisionit.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale gjatë këtyre tre muajve, aktivitet kryesor do të këtë shqyrtimin dhe amendamentimin e ligjeve, mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, monitorimin e resorëve të Qeverisë që bien në kompetencë të komisionit. Do të bashkëpunoj me të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, do të angazhoj ekspert dhe do të konsultohet me organizatat dhe shoqata jo qeveritare nga fusha e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

## **II. Anëtarët e Komisionit:**

1. Besa BAFTIU G/P-VV, Kryetare,
2. Enver HOTI G/P-NISMA, Zëvendëskryetar i parë,
3. Miljana NIKOLIQ G/P-LS, Zëvendëskryetare e dytë,
4. Fatmire KOLLQAKU-MULHAXHA G/P-VV, Anëtare,
5. Faton TOPALLI G/P-VV, Anëtar,
6. Haxhi AVDYLI G/P-LDK, Anëtar,
7. Naser RUGOVA G/P-LDK, Anëtar,
8. Flora BROVINA G/P-PDK, Anëtare,
9. Bekim HAXHIU G/P-PDK, Anëtar,
10. Time KADRIJAJ G/P-AAK, Anëtare
11. Fikrim DAMKA G/P-6+, Anëtar,

## **III. Personeli mbështetës:**

1. Shpresa Haxhijaj, Kordinatore e Komisionit;
2. Muhamet Bytyçi, Zyrtar i fushës.

[shpresa.ramosaj@assembly-kosova.org](mailto:shpresa.ramosaj@assembly-kosova.org)  
[muhamet.bytyci@assembly-kosova.org](mailto:muhamet.bytyci@assembly-kosova.org)

## **Objektivat:**

1. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale (KSHPMS) do të angazhohet maksimalisht në ndërtimin e infrastrukturës ligjore nën juridiksionin e tij.
2. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, do të grumbullojë informata përmes dëgjimeve publike dhe formave tjera të bashkëpunimit me qëllim të hartimit dhe amendamentimit sa më të mirë të projektligjeve.
3. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, do të formojë nën-komisione punuese, kur është e nevojshme, për të rritur efikasitetin dhe ekspertizën e tij.
4. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, do të zgjedh së paku një ligj në juridiksionin e tij; do të monitorojë implementimin e atij ligji dhe do të përgatisë raport lidhur me këtë.
5. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, do të bashkëpunojë rregullisht me Institucionet e Republikës së Kosovës, për të arritur rezultate në kryerjen e detyrave të tij.
6. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, do të bashkëpunojë rregullisht me organizata relevante ndërkombëtare dhe vendore si: USAID, NDI, UNDP, UNKT, UNICEF, OSBE, KDI etj.
7. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, do të punojë drejt ngritjes së cilësisë së punës dhe bashkëpunimit intern, si dhe ngritjes së kapacitetit të stafit të tij në kryerjen e detyrave të tyre.

## **Rregulla për organizimin e brendshëm:**

- Komisioni ndërtohet dhe funksionon në bazë të rregullores së Kuvendit.
- Dispozitat që rregullojnë kryesimin e Kuvendit janë bazë edhe për kryesimin e Komisionit;
- Komisioni ka Kryetarin dhe dy nënkryetarë;
- Komisioni ka stafin koordinues;
- Komisioni, me dy të tretat e votave, mund të krijojë një ose dy nën-komisione;
- Komisioni, për punë apo fusha të caktuara mund të krijojë grupe punuese;
- Nën-komisionet dhe grupet punuese i raportojnë komisionit.
- Komisioni mund të caktojë anëtarët e tij si raportues për një çështje ose fushë të caktuar;
- Mbledhjet e komisioni i thirr dhe i kryeson kryetari, ose, në mungesë të tij, nënkryetari;
- Mbledhjen e Komisionit mund ta thërrasin edhe një e treta e anëtarëve të Komisionit.
- Komisioni vendos me konsensus ose me shumicë votash;
- Deputeti që nuk pajtohet me qëndrimin e shumicës ka të drejtë t'i bashkangjese qëndrimin e vet raportit të Komisionit;
- Mbledhjet e Komisionit janë të hapura, përpos kur Komisioni vendos ndryshe;
- Në mbledhje të komisionit mund të ftohen dhe të marrin pjesë përfaqësuese të Qeverisë, përkatësisht ministrisë përkatëse, përfaqësues të institucioneve dhe asociacioneve të interesuar vendore e ndërkombëtare;

- Në punën e komisionit mund të angazhohen edhe këshilltarë ekspertë, në pajtim me udhëzimet procedurale e financiare të Kuvendit;
- Komisioni në punën e tij mund të shfrytëzojë edhe ndihmën e ekspertëve, institucioneve dhe asociacioneve ndërkombëtarë;

## ORGANIZIMI I BRENDSHËM

### Kryetari:

Drejton dhe koordinon punën e gjithmbarshme të Komisionit, në bashkëpunim me zëvendëskryetaret;  
Përfaqëson Komisionin, vetëm ose së bashku me nënkryetarët dhe anëtarët e komisionit, varësisht nga natyra e përfaqësimit;  
Raporton para Kuvendit për punën e Komisionit dhe paraqet qëndrimet e Komisionit;  
Për çështje të caktuara mund ta autorizojë nënkryetarët ose anëtarët raportues që të paraqesin qëndrimet e Komisionit.

### Zëvendëskryetaret:

Ndihmojnë kryetarin e Komisionit dhe e zëvendësojnë atë, kur ai mungon.  
Në marrëveshje me Kryetarin e Komisionit mbikëqyrin punën e grupeve punuese ose anëtarëve raportues për çështje ose fusha të caktuara, sipas vendimit të Komisionit;  
Në marrëveshje me Kryetarin e Komisionit paraqesin qëndrimet e Komisionit para Kuvendit.

### Raportuesit:

Anëtarët e komisionit mund të angazhohen për të raportuar për një çështje të caktuar, apo për të mbuluar dhe hulumtuar një fushë të caktuar dhe për t'i raportuar lidhur me të Komisionit.  
Me pëlqim të Komisionit dhe Kryetarit të tij, raportuesi mund t'i paraqesë qëndrimet e Komisionit edhe para Kuvendit.

## AGJENDA E KOMISIONIT NË MËNYRË TABELARE TETOR –DHJETOR 2017

Muaji	Agjenda e Komisionit	Detyrat e Komisionit
<b>TETOR</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për tetor – dhjetor 2017.</li> <li>2. Ministri i MSH raporton para Komisionit.</li> <li>3. Ministri i MPMS raporton para Komisionit.</li> <li>4. Komisioni shqyrton Projektligjin për ndërmarrjet sociale.</li> <li>5. Komisioni shqyrton Projektligjin për Inspektoratin Shëndetësor.</li> <li>6. Mbikëqyrja e zbatimit Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeveris së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.</li> <li>7. Vizita e anëtarëve të Komisionit në një institucion të përcaktuar për t'u vizituar.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Komisioni miraton planin e punës së Komisionit për tetor – dhjetor 2017.</li> <li>2. Takim njoftues si dhe prezantim nga ana e tij lidhur me sfidat dhe prioritetet apo objektivat që ka si Ministër i MSH-së.</li> <li>3. Takim njoftues si dhe prezantim nga ana e tij lidhur me sfidat dhe prioritetet apo objektivat që ka si i Ministër i MPMS-s..</li> <li>4. Komisioni shqyrton në parim Projektligjin për ndërmarrjet sociale.</li> <li>5. Komisioni shqyrton në parim Projektligjin për Inspektoratin Shëndetësor.</li> <li>6. Mbikëqyrja e zbatimit Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeveris së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.</li> <li>7. Njoftimi për së afërmi me punën dhe problemet e institucionit të vizituar.</li> </ol>

1. Komisioni shqyrton projektligjin për ndërmarrjet sociale.
2. Komisioni shqyrton projektligjin për Inspektoratin Shëndetësor.
3. Komisioni shqyrton projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131, për skemat pensionale të financuara nga shteti.
4. Komisioni shqyrton projektligjin për Inspektoratin e punës.
5. Komisioni shqyrton projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-101, për Transfuzionin e Gjakut, kontrollin e gjakut dhe produkteve të tije.
6. Mbikëqyrja e zbatimit Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeveris së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.
7. Shqyrtimi i raportit të Zyrës Kombëtarë të Auditimit për fondet e ndara për Sistemin e Informimit Shëndetësor –SISH, prej fillimit të implementimit të projektit deri në fund të muajit dhjetor 2016.
8. Bordi i SHSKUK-së si dhe Dr. Basri Sejdiu, UD. Drejtor i SHSKUK-së, raporton para Komisionit.
9. Vizita e anëtarëve të Komisionit në një institucion të përcaktuar për t’u vizituar.

1. Komisioni formon grupin punues për shqyrtimin e projektligjit për ndërmarrjet sociale.
2. Komisioni formon grupin punues për shqyrtimin e Projektligjit Inspektoratin Shëndetësor.
3. Komisioni shqyrton në parim projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131, për skemat pensionale të financuara nga shteti.
4. Komisioni shqyrton në parim projektligjin për Inspektoratin e punës.
5. Komisioni shqyrton në parim projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-101, për Transfuzionin e Gjakut, kontrollin e gjakut dhe produkteve të tije.
6. Mbikëqyrja e zbatimit Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeveris së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.
7. Shqyrtimi i raportit të Zyrës Kombëtarë të Auditimit për fondet e ndara për Sistemin e Informimit Shëndetësor –SISH, prej fillimit të implementimit të projektit deri në fund të muajit dhjetor 2016, procedimi për seancë.
8. Takim njoftues si dhe prezantim nga ana e tyre lidhur me sfidat dhe prioritetet apo objektivat që kanë.
9. Njoftimi për së afërmi me punën dhe problemet e institucionit të vizituar.

**DHJETOR**

- |  |   |
|--|---|
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Komisioni shqyrton Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 02/L-128 për barnat narkotike, substanca psikotrope dhe prekursorë.</li> <li>2. Komisioni shqyrton projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131, për skemat pensionale të financuara nga shteti.</li> <li>3. Komisioni shqyrton projektligjin për Inspektoratin e punës.</li> <li>4. Komisioni shqyrton projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-101, për Transfuzionin e Gjakut, kontrollin e gjakut dhe produkteve të tije.</li> <li>5. Komisioni shqyrton projektligjin për ndërmarrjet sociale.</li> <li>6. Komisioni shqyrton projektligjin për Inspektoratin Shëndetësor</li> <li>7. Shqyrtimi i projektbuxhetit për vitin 2018, për MSH , MPMS dhe SHSKUK.</li> <li>8. Vizita e anëtarëve të Komisionit në një institucion të përcaktuar për t'u vizituar.</li> </ol> | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Komisioni shqyrton në parim projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-128, për barnat narkotike, substanca psikotrope dhe prekursorë.</li> <li>2. Komisioni formon grupin punues për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131, për skemat pensionale të financuara nga shteti.</li> <li>3. Komisioni formon grupin punues për projektligjin për Inspektoratin e punës.</li> <li>4. Komisioni formon grupin punues për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-101, për Transfuzionin e Gjakut, kontrollin e gjakut dhe produkteve të tije.</li> <li>5. Komisioni miraton amendamentet e projektligjit për ndërmarrjet sociale.</li> <li>6. Komisioni miraton amendamentet e projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor.</li> <li>7. Komisioni shqyrton Projektbuxhetin e ministrive dhe institucioneve në fushëveprimin e Komisionit.</li> <li>8. Njoftimi për së afërmi me punën dhe problemet e institucionit të vizituar.</li> </ol> |
|--|---|

Prishtinë me;  
18 Tetor 2017

Kryetare e Komisionit  
**Besa Baftiu**